

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Krimeve të Rënda, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët Afrim Shala, kryetar i trupit gjykues, Emine Salihu dhe Luljeta Shabani, anëtare të trupit gjykues, me sekretaren juridike Fikrete Destani, në çështjen penale ndaj të akuzuarit A. B, nga P, për shkak të veprës penale fajdeja, nga neni 343 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës,¹ të cilin sipas autorizimit e mbron avokati..., si dhe ndaj të akuzuarit Xh. M, nga fshati S i E, Komuna e D, për shkak të veprës penale kanosja, nga neni 185 paragrafi 1 të KPRK, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati..., nga Gj, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.I.nr.261/2014, e datës 29 dhjetor 2014, të cilën e përfaqësonte prokurori Agron Uka, pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datat 23 maj 2016; 19 korrik 2016; 06 tetor 2016, 1 dhjetor 2016, 07 shkurt 2017, 2 maj 2017, ndërsa më datë 2 maj 2017 mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, kurse më datën 18 maj 2017 e përpilojë me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I.

I akuzuari A.B nga babai R dhe nëna Xh, e lindur B, i lindur më 16 tetor 1953, në fshatin V., Komuna e Ps, tani me vendbanim në P, rr.”.”, nr.... shqiptar, qytetar i Republikës së Kosovës, me numër personal 1009404780, i martuar, baba i tre fëmijëve, i papunë, inxhinier i diplomuar i teknologjisë ushqimore, i gjendjes së mesme ekonomike, duke u bazuar në nenin 364 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të Kodit të Procedurës Penale,²

LIROHET NGA AKUZA

Sepse kinse me qëllim që në mënyrë fare të lehtë dhe pa asnjë angazhim, të realizoj përfitim material të madh për vete apo për personin tjetër, ka kontraktuar një shumë dukshëm joproportionale të pasurisë në këmbim të shërbimit për personin tjetër, ashtu që duke shfrytëzuar gjendjen e rëndë financiare të të dëmtuarit M. R, më datë 9 prill 2008, pas një marrëveshje të arritur në restaurant “...”, në fshatin K, Komuna e Gj i njejtë fillimisht i huazon të dëmtuarit shumën prej 100.000 Euro, me interes mujor 3% për një muaj, për të cilën edhe përpilojnë një kontratë në të cilën specifikojnë kushtet e kontratës, në bazë të së cilës këto mjete huazohen në afat prej 1 viti me mundësi të zgjatjes së afatit në 2 vite, poashtu pas 1 viti i dëmtuari merr nga i pandehuri A.B shuma të ndryshme parash, njëherë 20.000 Euro dhe njëherë tjetër 25.000 Euro, duke

¹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), nr.04/L-082, i datës 20 prill 2012, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

² Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejme KPP), nr.04/L-123, i datës 13 dhjetor 2012, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013.

arritur shumën e përgjithshme prej 145.000 Euro, e që në pamundësi të kthimit të borxhit nga i dëmtuari, i njejtë më datë 23 mars 2011 në Ppërpilon një marrëveshje në bazë të së cilës nëse deri më datë 31 dhjetor 2011 nuk arrihet të kryhet obligimi sipas kontratës së datës 9 prill 2008, i cili kishte arritur në 300.000 Euro, atehërë interesi vjetor për këtë shumë do të jetë 7%, duke vazhduar dhe lidhur kontratë gojore deri më 29 prill 2014, kur i dëmtuari përmes një deklarate dhe një parakontrate i bartë te pandehurit dy banesa në Fushë Kosovë,

- me këtë kishte për të kryer veprën penale fajde, nga neni 343 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK.

II.

Ndaj të akuzuarit XH. M, nga babai D dhe nëna Z, e lindur B i lindur me datën, në fshatin S, Komuna e Dit, ku dhe tani jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, babë i tre fëmijëve, i papunë, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, konform nenit 363 paragrafi 1 nënparagrafi 1 të KPP,

REFUZOHET AKUZA

Sepse kinse nga data 23 dhjetor 2013 deri më datë 5 mars 2014 ka kanosur seriozisht të dëmtuarin M. Ri, përmes telefonit me nr....., me fjalë duke i dërguar sms me përmbajtje kërcënuese me qëllim që t'i bëj presion të dëmtuarit për t'ia kthyer borxhin të pandehurit A.B, në shumën e kontraktuar sipas marrëveshjeve të përmendura më lartë, ndër to më datë 5 mars 2014 rreth orës 17:28 i dërgon sms me fjalë: “Oh, ftyre millosheviqi, ti ke punë me A a Pasha ka pune me ty, deri sa të më përgjigjesh për borxh temin, oh rrenc, o hajn të kallxoj këto ditë kush është Pasha”, duke krijuar kështu tek i dëmtuari frikë, shqetësim, ankth dhe jetë të pasigurtë.

-me këtë kishte për të kryer veprën penale kanosje, nga neni 185 paragrafi 1 të KPRK.

Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

ARSYETIMI

1. Ecuria e procedurës dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP.I.nr.261/2014, me datë 29 dhjetor 2014 ndaj të akuzuarit A. B, nga P, për shkak të veprës penale fajdeja, nga neni 343 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK, si dhe ndaj të akuzuarit Xh.M, nga fshati S.i E Komuna e Dt, për shkak të veprës penale kanosja, nga neni 185 paragrafi 1 të KPRK.

Gjatë shqyrtimit fillestar, asnjëri nga të akuzuarit nuk e kishte pranuar fajësinë, ndërsa, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, të datës 6 tetor 2016, pasi që i dëmtuari M. R ka deklaruar se nuk i bashkangjitet ndjekjes penale ndaj të pandehurve dhe se nuk parashtron kërkesë pasurore-juridike është hudhur aktakuza e Prokurorisë Themelore në

Gjilan ndaj të akuzuarit Xh. M për shkak të vepres penale nën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për shkak se kjo vepër penale sipas nenit 185 paragrafi 6 të KPRK ndiqet sipas propozimit të palës së dëmtuar, ndërsa i dëmtuari M.R deklaroi se nuk i bashkangjitet ndjekjes penale ndaj dy të akuzuarve.

Prokurori i shtetit, Agron Uka, në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës sa i përket të akuzuarit A.B duke i propozuar trupit gjykues, që i njejtë të shpallet fajtor dhe të ndërshkohet sipas ligjit.

I akuzuari A. B dhe mbrojtësi i tij avokat në fjalën përfundimtare i kanë propozuar trupit gjykues që i akuzuari të lirohet nga akuza, pasi që nuk kemi të bëjmë me veprime inkriminuese të veprës penale të fajdes.

2. Konstatimet e trupit gjykues

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave, si dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera, konform nenit 361 të KPP, trupi gjykues konstatoi këtë gjendje faktike:

- se nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari të ketë kryer veprën penale fajdeja, nga neni 343 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK, në mënyrën, kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi.

3. Provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor

Gjendjen faktike të lartcekur, trupi gjykues e konstatoi pas administrimit të këtyre provave :

- dëgjimin e dëmtuarit M. R;
- dëgjimin e dëshmitarëve: Ismajl Rexhepi, L. R, B. R dhe E. D;
- leximin dhe shikimin e provave materiale, si dhe
- marrja në pyetje e të akuzuarit Agim Berisha.

3.1. Deklarimi i të dëmtuarit

I dëmtuari M. R, gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimi gjyqësor ka deklaruar se me të akuzuarin A.B.njihet nga E. D, i cili ka qenë inxhinier në kompaninë e tij dhe se mes vete kanë pasur raporte shumë të mira. Pasi që ju kanë nevojitur të holla për kompaninë e tij për prodhimin e betonit, ai në vitin 2008 ka marrur nga i akuzuari A. shumën prej 97.000 Euro nëpërmes bankës Raiffeisen dhe është dashur të paguaj 3% në muaj për afat të pacaktuar, edhe pse marrëveshja ka qenë që A t'ia lëshoj në konto shumën në vlerë prej 100.000 Euro dhe me rastin e huazimit të këtyre mjeteve monetare nuk ka lënë hipotekë. Në vitin 2009 nga i akuzuari ka pranuar shumën prej 25.000 Euro dhe 20.000 Euro, borxh këtë të cilin e ka përmbushur në vitin 2011. Për shkak të gjendjes jo të mirë financiare të kompanisë së tij ai nuk ka arritur që të përmbush borxhin me të holla ndaj A., andaj të njejtit i ka dhënë dy banesa në F. K, një kamion dhe një shumë të caktuar të të hollave. Më tutje ai ka deklaruar se në vitin 2008 pasuria e tij ka pasur vlerë 700.000 deri në 1.000.000 Euro. I dëmtuari ka deklaruar se ka paraqitur rastin në polici pasi që Xh.M.e ka kërcënuar që t'ia kthej borxhin A. në shumë prej 142.000 Euro, vlerë kjo e cila është trefishuar në emër të kamatës prej 3%.

Ai ka theksuar se nuk është e vërtetë që ai të ketë qenë i rrëmbyer dhe si pretext E t'i ketë thënë A për t'ia siguruar M 25.000 Euro. Në këtë rast ai nuk e ndien veten të dëmtuar sepse ai akoma i ka borxh të akuzuarit shumë prej rreth 7,000 Euro. E ka sqaruar se paratë nga i akuzuari Ai kam marrë për të blerë rërë, ciment dhe për të filluar punën dhe në bazë të marrëveshjes që kanë patur me A është dashur që paratë e huazuara t'i investoj në fabrikë. Gjithashtu, i dëmtuari e ka pohuar faktin se në prezencën e dëshmitarëve i ka thënë A që unë profitin e ka 10% dhe ka mundësi me mbulu kamatën tuaj prej 3% në muaj. Në fund, i dëmtuari ka shtuar se që nga vitit 1990 ka filluar të mirret me biznes.

3.2. Deklaratat e dëshmitarëve

3.2.1. Dëshmitari I. R., gjatë marrjes në pyetje në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nuk ka njohuri për detaje të punëve që ka pasur vëllai i tij-i dëmtuari M. R me të akuzuarin A por vetëm di që M. i ka borxh Ashumën prej 6200 Euro apo 6300 Euro, ngase pjesën tjetër të borxhit e ka përmbushur duke i'a dhënë dy banesa, një kamion si dhe një shumë të parave.

3.2.2. Dëshmitari L. R, gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se mixha tij M. R i ka marrë të hollat nga Apër të invenstuar në biznesin e tij, por pasi që nuk ka mundur t'ia kthej të hollat Agimit si kompenzim i ka dhënë banesa. Ai ka shtuar se e kishte nënshkruar kontratën e huamarrjes në cilësi të dëshmitarit, por nuk kishte pranuar që shtëpia e tij të lihej hipotekë dhe se nuk është e vërtetë që ai ka nënshkruar vërtetimin e datës 13 shkurt 2010, që është prezantuar në emër të kontratës.

3.2.3. Dëshmitari B. R, gjatë marrjes në pyetje në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se prindi i tij M. R .me qëllim që të investoj në biznesin e tij që nga viti 2008 ka marrë nga Ashumën prej 142.000 Euro me interes 3% dhe se ky i fundit në vitin 2011-2012 ka filluar që t'i kërkoj M që t'ia kthej të hollat. Ai poashtu ka shtuar se prindi i tij ka përmbushur pjesën më të madhe të detyrimit ndaj të akuzuarit duke i dhënë para kesh, një kamion dhe dy banesa në emër të borxhit të marrë por jo edhe në emër të interesit, përveç shumës prej 6.722 Euro. Më tutje ai ka përmendur se gjatë asaj kohe gjendja materiale në familjen e tyre ka qenë jo e mirë dhe se ai në emër të djalit të mixhës L. R. ka nënshkruar vërtetimin e datës 13 shkurt 2010 edhe pse atë nuk e ka lexuar, por babai i tij dhe i akuzuari A.B.i kanë kërkuar që ta nënshkruaj.

3.2.4. Dëshmitari E.D, gjatë marrjes në pyetje në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se fillimisht ai me M.kanë kërkuar nga A. që t'iu ndihmoj lidhur me marrjen e një kredie në Raiffeisen Bank në Prishtinë, pasi që i akuzuari e kishte vajzën të punësuar aty, mirëpo, këtë nuk kanë arritur ta bëjnë. Më tutje ai ka deklaruar se ka qenë prezent kur i dëmtuari M. R. ka kërkuar me ngulm të holla nga i akuzuari A. Bme qëllim që të investoj në firmen e tij. Gjithashtu, ka shtuar se ai ka qenë i pranishëm edhe kur janë nënshkruar marrëveshjet për huamarrje në mes të dy personave të lartëcekur. Sipas tij fillimisht A i ka bërë M transferin e të hollave në shumë prej 100.000 Euro, ashtu që 3000 Euro të fitimit çdo muaj t'ia japin A, ndërsa, më vonë Mustafa ka marrë nga Ahumën prej 25.000 Euro dhe 20.000 Euro. Por për shkak që më datë 13 nëntor 2007 i është ndërprerë marrëdhënia e punës në kompaninë e M., ai ka deklaruar se nuk ka njohuri se pse M.ka marrë nga i akuzuari shumë e fundit të të hollave në vlerë prej 45.000 Euro. Sipas tij në kohën kur Ai'a ka dhënë të hollat Mustafës kapitali i këtij të

fundit ka qenë në vlerë rreth 1.000.000 Euro dhe se firma e tij ishte duke e bërë ndërtimin e një shkolle në fshatin Zh. nga kjo punë kishin marrë rreth 600.000 Euro edhe pse puna ka mbetur e papërfunduar. Ai ka shtuar se ai ka qenë i pranishëm kur M.për borxhin e marrë A. i ka dhënë të holla, dy banesa dhe një kamion.

3.3. Provat materiale

Gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor janë administruar edhe këto prova materiale dhe atë : Parakontrata mbi shitblerjen e datës 29.04.2014; Kontrata mbi huazimin e mjeteve në vlerë prej 100.000 Euro, e datës 09.04.2008; Marrëveshja e datës 23.03.2011; Deklarata e shitblerjes së banesës nr.244/2013; Kopja e planit dhe certifikata mbi të drejtat e pronës në emër të L.R ; Kopja e librezës e kamionit Ivevo 44; Dëftesa mbi transaksionin bankar në vlerë prej 10.000 Euro nga Raiffeisen Bank; Dëftesa nr.2015; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve; Formularë prone dhe Vërtetimi i datës 13.02.2010. Faktet të cilat janë vërtetuar përmes këtyre provave materiale janë paraqitur tek 5.Vlerësimi dhe analizimi i provave.

3.4. Deklarimi i të akuzuarit

I akuzuari A.B, gjatë marrjes në pyetje në seancën e shqyrtimit gjyqësor e ka mohuar kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, duke shtuar se e konsideron veten të dëmtuar. Ai ka deklaruar se pasi që Mnuk kishte mundur të marrë kredi ai në Raiffeisen Bank i kishte dhënë Mustafës shumën prej 100.000 Euro me qëllim që t'i fus në funksion pajisjet e firmës dhe se 3% të fitimit në muaj t'i jepet atij. Edhe pse firma e M kishte filluar të punoj ai nuk i ishte përmbajtur marrëveshjes. Pas 4-5 muajsh M e ka larguar nga puna E dhe në atë kohë i akuzuari i kishte dhënë M shumën prej 20.000 Euro për blerjen e çimentos dhe shumën prej 25.000 Euro në kohën kur ky i fundit kishte qenë i rrëmbyer nga disa persona nga Sh, informata këto të cilat i akuzuari i kishte siguruar nga E. Ai ka shtuar se M në emër të borxhit nëpërmjet bankës i ka dhënë shumën e të hollave në vlerë prej 10.800 Euro, një kamion që ka pasur vlerë 12.000 Euro dhe dy banesa në Fushë Kosovë të cilat nuk janë akoma të përfunduara. Në fund i akuzuari A.B ka deklaruar se nëse nuk përfundojnë punimet në banesa M ka detyrim ndaj tij shumën prej 100.000 Euro, ndërsa nëse realizohen banesat në tërësi Mustafa i ka borxh shumën prej 10.000 Euro.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 343 paragrafi 1 të KPRK, është parashikuar se veprën penale fajdeja e kryen “kushdo që për vete apo për personin tjetër pranon ose kontraktin një shumë dukshëm joproportionale të pasurisë në këmbim të shërbimit për personin tjetër, duke shfrytëzuar gjendjen e rëndë financiare të personit të tillë, gjendjen e rëndë të banimit, varfërinë, papërvojën ose paaftësinë për të gjykuar”. Për këtë formë të kësaj vepre penale është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet. Forma më e rëndë e kësaj vepre penale është parashikuar në paragrafin 3 të nenit të lartcekur, e cila konsiderohet se është kryer nëse vepra penale nga paragrafi 1 të nenit të lartcekur rezulton me humbje financiare në shumë prej më tepër se

njëzetepesëmijë (25.000) Euro ose nëse kryesi ka realizuar dobi pasurore në shumë që tejkalon njëzetepesëmijë (25.000) Euro, për të cilën është parashikuar dënim me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dymbëdhjetë (12) vjet. Trupi gjykues, konstaton se për t'u konsideruar se është kryer kjo vepër penale, duhet që të përmbushen këto kushte: duhet që personi për vete apo për dikë tjetër të pranon ose kontraktin një shumë dukshëm joproportionale të pasurisë në këmbim të shërbimit për personin tjetër, duke shfrytëzuar gjendjen e rëndë financiare të personit të tillë, gjendjen e rëndë të banimit, varfërinë, papërvojën ose paaftësinë për të gjykuar.

5. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Trupi gjykues pas analizimit me shumë kujdes të të gjitha provave të administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, ka ardhur në përfundim se duhet t'i falet besimi i plotë deklarimeve të akuzuarit A. B, i cili e ka mohuar kryerjen e veprës penale e cila i është vënë në barrë. Trupi gjykues ja ka falur besimin e plotë deklaramit të akuzuarit, për shkak se deklarimi i tij, së pari është në harmoni me deklaramet e tij të mëparshme, kurse në anën tjetër gjejnë mbështetje edhe në provat materiale të cilat janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, në një mënyrë edhe me vetë deklaratën e të dëmtuarit M. R. Siç është cekur më parë, për të ekzistuar vepra penale për të cilën është akuzuar A. B duhet që personi për vete apo për dikë tjetër të pranoj ose të kontrakttoj një shumë dukshëm joproportionale të pasurisë në këmbim të shërbimit për personin tjetër, duke shfrytëzuar gjendjen e rëndë financiare të personit të tillë, gjendjen e rëndë të banimit, varfërinë, papërvojën ose paaftësinë për të gjykuar. Kjo është esenciale, çka do të thotë se pa ekzistimin e këtyre rrethanave nuk mund të ketë as vepër penale. Duke ju referuar kësaj pike, trupi gjykues ka ardhur në përfundim se këtë çështje penale, absolutisht nuk është vërtetuar me asnjë provë të vetme se i akuzuari A. B, të ketë kontraktuar ndonjë shumë dukshëm joproportionale të pasurisë në këmbim të shërbimit duke shfrytëzuar gjendjen e rëndë financiare, gjendjen e rëndë të banimit, varfërinë, papërvojën ose paaftësinë për të gjykuar të të dëmtuarit M. R, ngase në kohën kur Ai'a ka dhënë të hollat M kapitali i këtij të fundit ka qenë në vlerë rreth 1.000.000 Euro (Një milion Euro). Është me rëndësi të theksohen edhe provat materiale të cilat janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, përmes të cilave janë vërtetuar disa fakte relevante në këtë çështje penale. Me vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të M. R të bërë nga policia shihet se janë siguruar dokumentet siç janë : marrëveshje, dëftesa dhe deklarata të cilat kanë shërbyer si prova materiale gjatë procedurës penale. Nga parakontrata e noterizuar mbi shitblerjen e datës 29.04.2014 e lidhur në mes të N.P.N "Çlirimi" dhe A. B, gjykata ka konstatuar se një banesë në me sipërfaqe prej 86.96m² pas pranimit teknik do t'i kalonte në pronësi A.B me qëllim të pagimit të borxhit ndaj tij nga M.R. Në anën tjetër, pas analizimit të kontratës për huazimin e mjeteve e lidhur më datë 9 Prill 2008 në P, në mes të A.B, si huazues i mjeteve monetare dhe L. R dhe M.R si huamarrës, gjykata ka ardhur në përfundim se i akuzuari Agim Berisha i'a ka dhënë shumën prej 100.000 Euro të dëmtuarit M. R. Si provë tjetër materiale trupi gjykues ka shfrytëzuar edhe marrëveshjen e datës 23 Mars 2011, e lidhur në Pejë në mes të huadhënësit A. B dhe huamarrësve M.dhe L.R si dhe garantuesit E.D nga e cila është konstatuar se më datë 31 Dhjetor 2010 borxhi ndaj të akuzuarit ka qenë 308.800 Euro dhe në qoftë se borxhi nuk realizohet brenda kohës së kontraktuar interesi vjetor do të ishte 7%. Është me

rëndësi të potencohet se nga deklarata e shitblerjes së banesës nr.244/2013 të datës 26 Gusht 2013 është vërtetuar fakti se i dëmtuari M. R i ka shitur A.B një banesë në sipërfaqe prej 87 m² në vlerë prej 47,850 Euro, konform parakontratës të lidhur më datë 11.07.2013, në mes të N.P.N “Çlirimi” dhe M. R Më tutje nga formularët e pronës; nga kopja e planit dhe çertifikata mbi të drejtat e pronës në emër të L.B.është konstatuar fakti se ky i fundit është pronar i një shtëpie, e cila sipas vërtetimit të datës 13 Shkurt 2010 është konfirmar se është lënë garancion. Nga kopja e librezës e kamionit Ivevo 44 dhe vërtetimi i datës 13 Shkurt 2010 shihet se kamioni të cilin i dëmtuari M. i’ a ka dhënë të akuzuarit A.për përmbushjen e borxhit ka qenë në gjendje të mirë teknike dhe ka pasur vlerë prej 18.000 Euro. Me analizimin e dëftesës mbi transaksionin bankar të datës 29 Gusht 2008 nga Raiffeisen Bank gjykata arriti të vërtetoj se M. R. ka transferuar në llogari të A. B. shumë prej 10.000 Euro. Trupi gjykues në rastin konkret ka ardhur në përfundim se nuk mund të vërtetojë përtej dyshimit të bazuar se i akuzuari A.B. të ketë kryer veprën penale për të cilën është akuzuar. Aq më tepër kur nga provat materiale të lartëcekura, nga dëshmia e të dëmtuarit, dëshmitë e dëshmitarëve si dhe nga vetë deklarata e të akuzuarit gjykata arriti të vërtetojë faktin se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me veprime inkriminuese të cilat paraqesin vepër penale. Kjo për faktin se i dëmtuari M. R. në kohën e arritjes së marrëveshjes kishte pasuri në vlerë të madhe dhe atë në shumë prej rreth 1 Milion Euro, çka do të thotë se i njejt nuk kishte gjendje rëndë financiare, e as që kishte gjendjen e rëndë të banimit, apo i varfër. Në anën tjetër, nuk mund të thuhet as se i dëmtuari M.R. të ketë qenë i papërvojë për shkak se i njejt që nga viti 1990 mirret me biznes. Gjithashtu, nuk është vërtetuar se i dëmtuari të ketë qenë i paaftë për të gjykuar. Pra, nuk mund të bëhet fjalë për vepër penale të fajdes, aq më parë kur shuma e të hollave prej 100.000 Euro është transferuar edhe përmes llogarisë bankare, gjë që është një tregues shtesë së qëllimi i të akuzuarit A. B. nuk ka qenë që të kryejë ndonjë veprimtari që ndërlidhet me fajde, por, në këtë aspekt, trupi gjykues ja ka falur besimin të akuzuarit, i cili e kishte mohuar kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar. Faktet e tilla janë vërtetuar edhe nga dëshmitë e dëshmitarë që janë dëgjuar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, e të cilët në përgjigjësi janë vlerësuar si dëshmitarë të besueshëm për faktet që i kanë rrëfyer.

6. Vendimi për lirimin nga akuza, përkatësisht për refuzimin e akuzës

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë; në gjendjen e vërtetuar faktike, pas administrimit të provave, si dhe në nenin 364, paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KPP, trupi gjykues e liroi nga akuza të akuzuarin A.B., për kryerjen e vepres penale, siç është cekur në dispozitivin I të këtij aktgjykimi. Ndërsa, duke u bazuar në nenin konform nenit 363 paragrafi 1 nënparagrafi 1 të KPP, trupi gjykues e ka refuzuar akuzën sa i përket të akuzuarit Xh. M. për shkak të veprës penale sipas dispozitivit II të këtij aktgjykimi, për shkak se i dëmtuari M. R. është tërhequr nga ndjekja penale gjatë shqyrtimit gjyqësor, sa i përket kësaj vepre penale dhe se kjo vepër penale sipas nenit 185 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 1 të KPRK, ndiqet sipas propozimit të palës së dëmtuar.

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë duke u bazuar nën 454 paragrafi 1 të KPP.

Duke u bazuar në arsyet që u cekën më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Krimeve të Rënda

Më 18 maj 2017

Sekretarja juridike,
Fikrete Destani

Kryetari i trupit gjykues,
Afrim Shala

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.